



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A**

**MANUALE/DOKUMENTE, POLITIKA QË KANË LIDHJE ME FUNKSIONET E
“IDENTITEK” SHA DHE QË PREK PUBLIKUN**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A**

Përmbajtja

1	Përshkrimi dhe konteksti	3
1.1	Objekti i veprimtarisë dhe shërbimet që ofron IdentiTek	3
1.2	Misioni, Vizioni, Qëllimi dhe Objektivat e Shoqërisë	4
1.2.1	Misioni	4
1.2.2	Vizioni.....	4
1.2.3	Qëllimi	5
1.3	Organizimi Hierarkik	5
1.4	Divizione dhe Departamente	5
1.5	Informacion i Dokumentuar	9
2	Standardet ndërkombëtare	10
2.1	ISO27001:2022	10
2.1.1	Rëndësia e ISO 27001:2022.....	10
2.1.2	Përfitimet e Zbatimit të ISO 27001:2022.....	10
2.2	Standardi ICAO - Siguria e Dokumenteve të Udhëtimit.....	11
2.2.1	Rëndësia e Standardit ICAO.....	11
2.2.2	Përfitimet e përputhshmërisë me ICAO.....	11



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A**

1 Përshkrimi dhe konteksti

shoqëri aksionare me kapital tërësisht shtetëror e krijuar me VKM Nr.80, datë 14.02.2023, “Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike”.

Shoqëria IdentiTek SHA prodhon dokumente identifikimi biometrike me standarde të larta sigurie, si pasaporta biometrike, letërnjoftime elektronike, leje qëndrimi biometrike për të huajt, etj. Për të njëjtat çështje, Shoqëria mund të kryejë veprimtari projektimi, këshillimi, konsultimi për subjekte publike dhe private si dhe çdo shërbim tjetër në përputhje me qëllimin e krijimit dhe statutin e tij.

Selia e IdentiTek SHA ndodhet në Tiranë, por aktiviteti i saj shtrihet në të gjithë Shqipërinë, kryesisht me pikat e aplikimit dhe shpërndarjes së dokumenteve biometrike për shtetasit shqiptarë dhe të huaj që jetojnë në Shqipëri, si dhe në Përfaqësitë Diplomatike (Ambasadat, Konsullatat) e Shqipërisë në vende të ndryshme.

1.1 Objekti i veprimtarisë dhe shërbimet që ofron IdentiTek

IdentiTek është një shoqëri e specializuar në ofrimin e shërbimeve të prodhimit dhe shpërndarjes së dokumenteve biometrike dhe elektronike, kundrejt pagesës. Këtu përfshihen:

1. Letërnjoftime Elektronike dhe Pasaporta Biometrike:

- Letërnjoftime elektronike për qytetarët shqiptarë.
- Pasaporta të zakonshme, të shërbimit dhe diplomatike.

2. Dokumente Biometrike për të Huajt:

- a. Leje qëndrimi për të huajt për çdo motiv, përveç lejeve provizore dhe humanitare.

3. Letërnjoftime Elektronike për Refugjatët:

- b. Letërnjoftime elektronike për personat që kanë përfituar statusin e refugjatit dhe mbrojtje plotësuese.

4. Dokumente Udhëtimi për Refugjatët:



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A**

- c. Dokumente udhëtimi për personat që kanë përfituar statusin e refugjatit dhe mbrojtje plotësuese.

Përveç këtyre, IdentiTek ofron shërbime shtesë në përputhje me legjislacionin në fuqi për subjekte publike dhe private si Studim, Projektim, Këshillim dhe Konsultim për dokumentet e përmendura më lart.

IdentiTek, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të reja dhe/ose krijimin e shoqërive si edhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Për përmbushjen e veprimtarive të saj, IdentiTek bashkëpunon me persona fizikë dhe juridikë brenda dhe jashtë Shqipërisë. Këto bashkëpunime ndihmojnë në realizimin efektiv dhe efikas të shërbimeve dhe produkteve që ofron shoqëria jonë.

1.2 Misioni, Vizioni, Qëllimi dhe Objektivat e Shoqërisë

1.2.1 Misioni

IdentiTek ka si mision të ofrojë shërbime të një niveli të lartë sigurie, me integritet, të specializuar dhe në përmirësim të vazhdueshëm për prodhimin e dokumenteve biometrike në përputhje me standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare për shtetasit shqiptarë brenda dhe jashtë vendit dhe shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri.

1.2.2 Vizioni

Vizioni i IdentiTek është lider në fushën e shërbimeve të identifikimit biometrik dhe personalizimit të sigurt në territorin e Republikës së Shqipërisë me synim edhe përtej tij. Synojmë të ndërtojmë një standard dhe reputacion të padiskutueshëm për cilësi dhe profesionalizëm, duke u angazhuar në inovacionin e vazhdueshëm dhe ofrimin e zgjidhjeve të avancuara teknologjike.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A**

1.2.3 Qëllimi

IdentiTek ka si qëllim kryesor të ofrojë shërbime profesionale, të besueshme dhe efikase për prodhimin e dokumenteve biometrike, duke përfshirë të gjithë hapat nga aplikimi tek shpërndarja e tyre, për shtetasit shqiptarë brenda e jashtë vendit dhe shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri.

1.3 Organizimi Hierarkik

Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë përbëhen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori. Kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre kryesore janë të përcaktuara në Statutin e Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme

Merr vendime për përcaktimin dhe miratimin e politikave të përgjithshme tregtare dhe të investimit (përfshirë programin ekonomik-financiar) të Shoqërisë; monitoron dhe mbikëqyr performancën e Këshillit Mbikëqyrës; miraton pasqyrat financiare vjetore; miraton rregulloret e brendshme mbi funksionimin e shoqërisë, etj..

Këshilli Mbikëqyrës

Mbikëqyr dhe këshillon mbi politikat dhe strategjitë e shoqërisë, siguron që drejtimi i shoqërisë të jetë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e saj.

Auditi i Brendshëm

Kryen kontrolle dhe auditime të brendshme për të siguruar që të gjitha proceset dhe veprimet e shoqërisë janë në përputhje me politikat dhe procedurat e saj dhe identifikon fushat për përmirësim.

Administrator

Kryen funksione administrative dhe mbështetëse, duke përfshirë menaxhimin e burimeve dhe koordinimin e aktiviteteve të ndryshme të divizioneve e departamenteve.

1.4 Divizione dhe Departamente

Organizimi i brendshëm i Shoqërisë



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A**

Shoqëria është e strukturuar në divizione, departamente dhe sektorë të ndryshëm, sipas miratimit të Asamblesë së Përgjithshme. Organizimi i saj përfshin tre divizione kryesore për teknologjinë e informacionit, aktivitetet operacionale dhe shërbimet mbështetëse.

I. Divizioni i Sistemeve dhe Informacionit

Divizioni i Sistemeve dhe Informacionit është përgjegjës për zhvillimin, implementimin dhe operimin e sistemeve informatike, duke siguruar përputhshmërinë me qëllimet dhe nevojat e shoqërisë në fushën e teknologjisë dhe sigurisë së informacionit. Ky divizion përbëhet nga Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit, Departamenti i Sigurisë së Informacionit (CISO), dhe Departamenti i Zhvillimit të Aplikacioneve IT.

a. Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit

Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit harton, përditëson dhe zhvillon strategjinë e teknologjisë së informacionit, duke hartuar dhe zbatuar sisteme dhe shërbime të reja në përputhje me objektivat e shoqërisë. Ky departament përbëhet nga:

Sektori i Sigurisë së Rrjetit Kompjuterik dhe Shërbimeve IT, i cili siguron burimet infrastrukturore dhe planifikon proceset kompjuterike, dhe

Sektori i Sistemeve dhe Infrastrukturës së IT, i cili menaxhon dhe mbron sistemin, si dhe monitoron integrimin e versioneve të reja të softuerit.

b. Departamenti i Sigurisë së Informacionit

Departamenti i Sigurisë së Informacionit “CISO” është përgjegjës për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të mundshme për sigurinë e të dhënave, duke hartuar politika dhe udhëzime për mbrojtjen e tyre. Ky departament monitoron dhe analizon ngjarjet e sigurisë në bashkëpunim me ekipet e IT-së, duke adresuar incidentet përmes mjeteve të monitorimit për të identifikuar ndërhyrjet e padëshiruara dhe aktivitetet e dyshimta.

c. Departamenti i Zhvillimit të Aplikacioneve IT

Departamenti i Zhvillimit të Aplikacioneve IT ka përgjegjësi kryesore krijimin dhe implementimin e zgjidhjeve inovative softuerike, si dhe drejtimin strategjik dhe operacional të projekteve të zhvillimit në bashkëpunim me të gjithë aktorët e rëndësishëm brenda dhe jashtë shoqërisë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A**

II. Divizioni i Operacioneve

Divizioni i Operacioneve është përgjegjës për implementimin e procedurave të regjistrimit, ndjekjen e procesit të investigimit dhe verifikimit të cilësisë së të dhënave, personalizimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike. Ky divizion përbëhet nga Departamenti i Regjistrimit, Departamenti i Investigimit dhe Cilësisë së të Dhënave, Departamenti i Prodhimit dhe Departamenti i Cilësisë dhe Standardeve.

a. Departamenti i Regjistrimit

Departamenti i Regjistrimit është përgjegjës për ndjekjen e veprimtarisë së aplikimit të shtetasve në Zyrat e Aplikimit pranë Bashkive apo njësive administrative, si dhe për shpërndarjen e dokumenteve biometrike. Ky departament gjithashtu koordinon procesin e regjistrimit që kryhet pranë Ambasadave dhe Konsullatave të Republikës së Shqipërisë.

b. Departamenti i Investigimit dhe Cilësisë së të Dhënave

Departamenti i Investigimit dhe Cilësisë së të Dhënave është një njësi kyçe e shoqërisë, përgjegjëse për sigurimin e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të mbledhura gjatë personalizimit të dokumenteve biometrike. Ky departament zbaton masa kontrolli të cilësisë, procese vërtetimi të të dhënave, dhe teknika për ruajtjen e integritetit të tyre, duke mbajtur gjithashtu komunikimin me organet ligjzbatuese për përmbushjen e veprimtarisë së tij.

c. Departamenti i Prodhimit

Departamenti i Prodhimit është një komponent thelbësor i institucionit, përgjegjës për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e kontratave të furnizimit me dokumente biometrike. Ky departament menaxhon burimet thelbësore për prodhimin, përfshirë lëndët e para dhe pajisjet, dhe zbaton masa kontrolli të cilësisë për të siguruar që lëndët e para dhe produktet e punës përmbushin standardet e specifikuar.

d. Departamenti i Cilësisë dhe Standardeve

Departamenti i Cilësisë dhe Standardeve është përgjegjës për monitorimin, ndjekjen dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare të cilësisë, duke vendosur procese për monitorimin, auditimin dhe përmirësimin e cilësisë për të gjitha aktivitetet e shoqërisë. Ky departament zbaton sisteme të menaxhimit të cilësisë, përfshirë ISO 27001 dhe standarde të tjera.

III. Divizioni i Shërbimeve Mbështetëse



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A**

Divizioni i Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjës për garantimin dhe planifikimin e burimeve financiare, verifikimin e ligjshmërisë së akteve administrative dhe mbikëqyrjen e sigurisë fizike dhe logjistikës. Ky divizion përbëhet nga katër departamente (Ligjor, Prokurimeve Publike, Sigurisë Fizike, Logjistikës dhe Mirëmbajtjes, Marketingut dhe Komunikimit) dhe një sektor (Arkivë-Protokollit).

a. Departamenti Ligjor

Departamenti Ligjor është përgjegjës për verifikimin e bazueshmërisë ligjore të të gjitha akteve administrative të Shoqërisë. Ky departament ndjek çështjet ligjore në gjykata, bashkëpunon me departamentet e tjera për hartimin e akteve dhe koordinon procesin e propozimit të vendimmarrjes për organet e Shoqërisë.

b. Departamenti i Prokurimeve Publike

Departamenti i Prokurimeve Publike është përgjegjës për menaxhimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit në kohë. Ky departament koordinon procesin e prokurimeve me njësitë dhe departamentet e përfshira, monitoron dhe verifikon dosjet e procedurave për arkivimin e tyre sipas ligjit, dhe raporton periodikisht pranë autoriteteve përgjegjëse.

c. Departamenti i Sigurisë Fizike, Logjistikës dhe Mirëmbajtjes

është përgjegjës për ruajtjen e aseteve fizike, menaxhimin e operacioneve logjistike dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve. Ky departament zbaton dhe administron sistemet e aksesit dhe daljes nga objektet, monitoron CCTV dhe sistemet e vëzhgimit për të parandaluar kërcënimet e sigurisë, dhe menaxhon procedurat e prokurimit të planifikuara.

d. Departamenti i Marketingut dhe Komunikimit

është përgjegjës për strategjitë e komunikimit dhe marrëdhëniet me publikun, duke zhvilluar imazhin e kompanisë. Ky departament krijon dhe implementon materiale inovative në fushën e marketingut, bashkëpunon me departamentet për krijimin dhe mirëmbajtjen e materialeve promovuese, mban kontakte me Ministrinë e Brendshme për koordinimin e publikimeve, dhe përditëson faqen e internetit të Shoqërisë me lajme dhe informacione të ndryshme.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A**

e. Sektori i Arkivit dhe Protokollit

është përgjegjës për zbatimin e kritereve ligjore në fushën e arkivimit të dokumenteve dhe shpërndarjes së korrespondencës. Ky sektor harton raporte periodike për shkresat dhe përgjigjet, siguron drejtimin administrativ dhe metodologjik të arkivit.

f. Departamenti i Burimeve Njerëzore

është përgjegjës për sigurimin e zbatimit të Kodit të Punës dhe akteve nënligjore në fuqi. Ky departament mbikëqyr procedurat ligjore për menaxhimin e burimeve njerëzore, duke përfshirë rekrutimin dhe vlerësimin e rezultateve në punë, dhe harton raporte dhe analiza në këtë fushë.

g. Departamenti i Financës dhe Planifikimit Financiar

është përgjegjës për garantimin e planifikimit financiar dhe menaxhimin e burimeve financiare. Ky departament kryen analiza të ndryshme dhe harton raporte periodike për organet drejtuese të Shoqërisë, si dhe ndjek dhe zbaton legjislacionin tatimor në përmbushje të afateve ligjore.

h. Departamenti i Projekteve dhe Inovacionit

është përgjegjës për implementimin e projekteve të reja në fushën e inovacionit, në përputhje me aktivitetet dhe strategjitë e zhvillimit të Shoqërisë. Ky departament koordinon aktivitetet e inovacionit me strukturat homologe në Ministrinë e Brendshme dhe institucionet publike, dhe siguron që projektet e krijuara të përputhen me strategjitë dhe qëllimet e përgjithshme për zhvillimin e Shoqërisë.

1.5 Informacion i Dokumentuar

IdentiTek përveç përputshmërisë me legjislacionin kombëtar dhe standardeve ndërkombëtare gjeneron dhe menaxhon dokumente, politika dhe procedura të brendshme përmes të cilave operon në procese të ndryshme në mënyre të standardizuar ku qartësohen hapat që ndiqen dhe pritshmëritë për rezultatin final.

Këto dokumente, politika dhe procedura menaxhohen dhe përditësohen live për të qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me evolucionin e proceseve dhe teknologjisë së aplikuar.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A**

Aktualisht IdentiTek ka aktive 218 të tilla që përcaktojnë çdo proces, nënproces dhe përgjegjësitë përkatëse në operimin e IdentiTek.

2 Standardet ndërkombëtare

2.1 ISO27001:2022

ISO 27001:2022 është një standard ndërkombëtar i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim për menaxhimin e sigurisë së informacionit që mundëson një qasje të strukturuar dhe certifikuar ndërkombëtarisht për mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm (veçanërisht të dhënat personale të qytetareve) në përputhje me praktikat më të mira të sigurisë.

Shoqëria është e certifikuar me ISO 27001:2022 që prej Korrik 2024 nga prestigjiozja TUV Austria, dhe gjithashtu ka trajnuar një skuadër brenda stafit me kompetencat e Lead Auditor ISO27001:2022.

2.1.1 Rëndësia e ISO 27001:2022

- **Mbrojtja e Informacionit:** Mbron informacionin konfidencial dhe të ndjeshëm nga akseset e paautorizuara, humbja dhe dëmtimi.
- **Besueshmëri dhe Integritet:** Ndihmon në ndërtimin e besimit tek klientët dhe partnerët, duke treguar përkushtim ndaj sigurisë.
- **Përputhshmëria Ligjore:** Siguron përputhje me rregulloret dhe kërkesat ligjore për mbrojtjen e të dhënave.
- **Menaxhimi i Rreziqeve:** Ofron një qasje të strukturuar për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit.

2.1.2 Përfitimet e Zbatimit të ISO 27001:2022

- **Reduktimi i Rreziqeve:** Zvogëlon mundësinë dhe ndikimin e incidenteve të sigurisë.
- **Përmirësimi i Reputacionit:** Rrit besimin e klientëve dhe partnerëve në aftësitë tona për mbrojtjen e informacionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A

- **Eficienca Operative:** Përmirëson efikasitetin operacional përmes procedurave të standardizuara.
- **Konformiteti Ligjor:** Siguron përputhshmëri me rregulloret dhe shmang gjobat dhe penalitetet.

Zbatimi dhe mirëmbajtja e standardit ISO 27001:2022 është një dëshmi e angazhimit tonë për sigurinë e informacionit dhe përkushtimit ndaj praktikave më të mira të sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Stafi i IdentiTek mbështet dhe kontribuon në këtë përpjekje për të siguruar mbrojtjen e informacionit.

2.2 Standardi ICAO - Siguria e Dokumenteve të Udhëtimit

ICAO (Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil) përcakton standarde globale për dokumentet e udhëtimit. Përputhshmëria e dokumenteve të identitetit shqiptarë me parametrat e parashtruar nga standardi ICAO i bën dokumentet shqiptarë të identitetit të sigurt dhe të besueshme ndërkombëtarisht. Pasaportat biometrike shqiptarë janë në përputhje me standardin ICAO.

2.2.1 Rëndësia e Standardit ICAO

- **Siguria e Dokumenteve:** Siguron që dokumentet e udhëtimit të jenë të mbrojtura kundër falsifikimit dhe keqpërdorimit.
- **Besueshmëri Ndërkombëtare:** Njohja dhe pranimi ndërkombëtar i dokumenteve tona të udhëtimit nga të gjitha vendet anëtare të ICAO.
- **Përputhshmëria Ligjore:** Siguron që dokumentet tona të udhëtimit përmbushin kërkesat ligjore dhe rregulloret ndërkombëtare.
- **Lehtësimi i Udhëtimit:** Ndhmon në lehtësimin e procesit të udhëtimit për qytetarët tanë, duke reduktuar kohën e pritjes dhe kontrollet shtesë në pikat kufitare.

2.2.2 Përfitimet e përputhshmërisë me ICAO

- **Mbrojtja kundër Falsifikimit:** Rrit sigurinë e dokumenteve të udhëtimit duke i bërë ato më të vështira për t'u falsifikuar.
- **Njohja Ndërkombëtare:** Dokumentet tona të udhëtimit janë të njohura dhe të pranueshme në të gjitha vendet anëtare të ICAO.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
IDENTITEK SH.A**

- **Lehtësimi i Udhëtimit:** Redukton kohën e pritjes dhe kontrollet shtesë në kufij, duke lehtësuar udhëtimin për qytetarët tanë.

Besueshmëria dhe Siguria: Rrit besueshmërinë dhe sigurinë e dokumenteve tona të udhëtimit në nivel ndërkombëtar.